

# Übersetzungen der Dialoge

## Përkthimet e dialogëve

### Mësimi 1

#### Kjo është një këngë

Në mësimin e parë jepen disa shembuj që tregojnë se si flitet gjermanishtja. Kjo ju jep një ide se si tingëllon kjo gjuhë edhe pse nuk i kuptoni fjalët. Andrea, njëri nga personazhet kryesore të kursit radiofonik, do t'ju shpjegojë më hollësisht dy nga këta shembuj.

**Andreas:**

Kjo është një këngë.

Kjo është një këngë nga Klaus Hofman.

Ky është një tekst.

Ky është një tekst nga Gëte.

### Mësimi 2

#### Ej, taksi!

Qëllimi i këtij mësimi është që t'ju njobë me disa metoda (teknika), të cilat mund t'ju ndibmojnë për të kuptuar një gjuhë të huaj. Një nga këto metoda është kombinimi i fjalëve që njibni (nga shqipja ose nga ndonjë gjuhë tjeter) me zhvillimin e veprimit në një situatë të dhënë. – Skena e mëposhtme zhvillohet në rrugë: dr. Tyrmani, një klient i rregullt i hotelit "Europa" thërret një taksi. Pasi takzia afrohet dr. Tyrmani bëpën në të dbe i thotë shoferit të taksisë (= **Taxifahrer**) se ku dëshiron të shkojë.

**Dr. Thürmann:** Hej, taksi!

**Taxifahrer:** Tungjatjeta.

**Dr. Thürmann:** Tungjatjeta. Në hotel "Europa", ju lutem.

**Taxifahrer:** Hotel "Europa". Në rregull.

### Mësimi 3

#### Hotel "Europa"

Në këtë mësim ju kuptoni se kursi ynë i gjuhës zhvillohet në një hotel, në hotelin "Europa". Personazhet kryesore të kursit, me të cilat njiheni këtu janë: drejtoresha e hotelit **Frau Berger**, sportelisti **Andreas Schäfer**, pastruesja e dhomave **Hanna Clasen** dhe **Ex**, një personazh imagjinar që ndeshet në përrallat dbe tregimet popullore. Pastaj vjen **dr. Thürmann**, një klient i rregullt i hotelit "Europa" dbe më në fund vjen prezantuesi ose folësi (= **Sprecher**), i cili shpjegon, së bashku me një kolege, gramatikën dhe paraqet personazhet.

**Sprecher:** Ky është zoti Shefer, Andrea Shefer.

Ky është doktor Tyrman.

Kjo është zonja Berger, Liza Berger.

Kjo është Hana, Hana Klazen.

*Kurse Eksa prezantohet vetë.*

**Ex:** *Tungjatjeta! Tungjatjeta! Ja ku jam, ja ku jam unë.*

*Eksa përsërit emrat e personazheve kryesorë të kursit.*

**Ex:** *Jam unë dbe Andrea dbe zonja Berger dbe Hana dbe dr. Tyrmani.*

*Andrea nuk prezantohet, por atë e dëgjoni duke folur në telefon, në sportelin e hotelit "Europa".*

**Andreas:** *Sporteli. Mirëmbërëma. Hotel Europa, sporteli.*

#### **Mësimi 4**

#### **Kush jeni ju, ju lutem?**

*Dr. Tyrmani është klient i rregullt në hotelin "Europa". Ai mbërrin në hotel, ku pritet në mënyrë miqësore nga drejtoresha, zonja Berger.*

**Frau Berger:** *Abi! – Zoti Tyrman! Ju uroj të kaloni një mbrëmje të këndshme.*

**Dr. Thürmann:** *Mirëmbërëma!*

**Frau Berger:** *Zoti Shefer, ky është dr. Tyrman.*

**Andreas:** *Mirëmbërëma, zoti doktor.*

**Ex:** *'mbrëma.*

**Andreas:** *Shëët, Eks, shëëët!*

*Pak më vonë, dr. Tyrman telefonon në sportel dhe porosit një birrë. Dr. Tyrmani nuk dëgjon mirë.*

**Andreas:** *Sporteli. Mirëmbërëma.*

**Dr. Thürmann:** *Si thatë? Kush jeni?*

**Andreas:** *Sporteli. Hotel "Europa".*

**Dr. Thürmann:** *Më falni, kush flet?*

**Andreas:** *Hotel "Europa". Sporteli.*

**Dr. Thürmann:** *Aba. Dëshiroj një birrë. Një birrë, ju lutem.*

**Andreas:** *Një birrë, në rregull. Me kë po flas, ju lutem?*

*Andrea nuk e njeh menjëherë zërin e dr. Tyrmanit, gjë që e mërzit shumë dr. Tyrmanin.*

**Dr. Thürmann:** *Tyrman. Dr. Tyrman. Po ju, cili jeni?*

**Andreas:** *Unë jam sportelisti.*

**Dr. Thürmann:** *Dhe si qubeni ju?*

**Andreas:** *Andrea Shefer.*

**Dr. Thürmann:** *Aba. Shefer. Shefer – epo mirë.*

*Dhe sikur të mos mjaftonte kjo, Eksa i drejtohet fare pa vend me "ti" dr. Tyrmanit.*

**Ex:** *Po ti, kush je?*

**Dr. Thürmann:** *Ti? Kush je ti? Hm...*

**Andreas:** *Më falni! Më vjen keq!*

## **Mësimi 5**

### **Po kjo është e pabijshme!**

*Andrea i sjell në dhomë dr. Tyrmanit birrën që ka porositur. Dr. Tyrmani shpreh babinë që i janë drejtar me "ti". Ai i jep të kuptojë Andreas se kjo është një sjellje e pabijshme.*

*(Trokët dera)*

**Dr. Thürmann:** Po. Hyni.

**Andreas:** Birra juaj, zotëri.

**Dr. Thürmann:** Ju faleminderit! Ju jeni sportelisti, apo jo?

**Andreas:** Po.

**Dr. Thürmann:** Mirë, unë jam ... jam i çuditur. Pse më drejtobeni me "ti"?

**Andreas:** Kush? Unë?

**Dr. Thürmann:** Jo, jo, jo. Kjo është e pabijshme, djalosh!

**Andreas:** Më vjen keq. Më falni, ju lutem.

*Dr. Tyrmani thotë gjysëm me shaka se Andrea është pak shakaxhi. Pastaj ai ndahet nga Andrea, sepse është i lodhur.*

**Dr. Thürmann:** Jeni pak shakaxhi, më duket.

**Andreas:** Shakaxhi?

**Ex:** Jo shakaxhi – vitore, kukudh. Unë jam vitore.

**Dr. Thürmann:** Mirë – shakaxhi apo kukudh ... unë jam i lodhur. Natën e mirë.

**Andreas:** Natën e mirë, zoti doktor.

*Tani Andrea, më në fund, ka rast t'i thotë Eksës se sjellja e saj është e pabijshme.*

**Andreas:** Eks? Eks?

**Ex:** Po, ç'ke?

**Andreas:** Ti je e pasjellshme.

**Ex:** Unë? È pasjellshme?

**Andreas:** Po, ti.

**Ex:** Më vjen keq, unë...

**Andreas:** Është mungesë respekti të thuash: "Po ti, kush je?"

**Ex:** Unë jam e lodhur...

**Andreas:** Jo, ti je kukudh.

## **Mësimi 6**

### **Me se merreni ju?**

*Dr. Tyrmani ju lut Andreas të vinte në dhomën e tij për të biseduar. Ai kërkon të mësojë se me se merret Andrea, prandaj e pyet atë me hollësi. Andrea studion për gazetari. Njëkohësisht ai shkruan reportazhe. Për ndonjë arsy, kjo i duket dr. Tyrmanit interesante.*

**Dr. Thürmann:** Po. Hyni!

**Andreas:** Mirëmëngjes, zoti doktor.

**Dr. Thürmann:** Mirëmëngjes, djalosh. Mund të më thoni: me se merreni ju?

**Andreas:** Une vazhdoj studimet.

- Dr. Thürmann:** Studioni dhe nuk dini të sllenit? Po për se studioni?  
**Andreas:** Për gazetari.  
**Dr. Thürmann:** Dhe çfarë bëni atje konkretisht?  
**Andreas:** Bëj kërkime dhe shkruaj reportazhe.  
**Dr. Thürmann:** Interesante, shumë interesante.

*Andrea punon në hotel "Europa" që të fitojë të holla për të përballuar studimet.*

- Dr. Thürmann:** Po këtu në hotel, çfarë bëni?  
**Andreas:** Këtu? Punoj.  
**Dr. Thürmann:** Ç' punë bëni?  
**Andreas:** Jam sportelist.  
**Dr. Thürmann:** Ju jeni i ri në këtë punë, apo jo?  
**Andreas:** Po.  
**Dr. Thürmann:** Pra, ju studioni përgazetari dhe punoni këtu.  
**Andreas:** Keni nevojë për para, besoj. Apo jo?  
**Dr. Thürmann:** Po. Natyrisht.  
**Andreas:** Interesante. Mirë, mirupafshim.  
**Dr. Thürmann:** Mirupafshim, zoti doktor.

*Kurse Eksa e përmbledh bisedën në formën e një vargu me rimë.*

- Ex:** Studim dbe bulumtim – interesante, shumë interesante.

### **Mësimi 7** **Ti je e çuditshme.**

*Andrea studion përgazetari, kurse Eksa, sipas saj, "studion" qeniet njerëzore.*

- Ex:** Tungjatjeta, Andrea!  
**Andreas:** Ç' po bën këtu?  
**Ex:** Po studioj.  
**Andreas:** Më fal, po studion?!  
**Ex:** Po, po studioj.  
**Andreas:** E çfarë po studion?  
**Ex:** Njerëzit.  
**Andreas:** Aha. Ti po studion njerëzit.  
**Ex:** Po. Po bëj studime. Ünë studioj njerëzit.  
**Andreas:** Oh, ti je e çuditshme.  
**Ex:** Edhe qeniet njerëzore janë të çuditshme.

*Andrea mediton për natyrën njerëzore – Eksa mendon se Njeriu është para së gjithash i çuditshëm dbe kureshtar.*

- Andreas:** Qeniet njerëzore, hm, njeriu, hm... Si është Njeriu?  
**Ex:** I pasjellshëm, i lodbur, interesant dbe i çuditshëm.  
**Andreas:** Më fal, çfarë the?  
**Ex:** Njeriu është i pasjellshëm, i lodbur, shumë interesant, i çuditshëm dbe kureshtar.

## **Mësimi 8**

### **Nga je ti?**

Skenat e mëposhtme zhvillohen në dhomën ku babet mëngjesi në hotel "Europa". Ju mësoni se si Eksa dbe Andrea njihen me njëri-tjetrin. Në skenën e parë do të njiheni me Hana Klazen, që punon si pastruese dhomash në hotel "Europa". Asaj i bie nga dora një tabaka me pjata. Por një klient i sjellshëm e ndihmon t'i mbledhë ato.

- 1. junge Frau:** Mirëmëngjes.  
**2. junge Frau:** Mirëmëngjes.

(Një tabaka me pjata bie përtokë me zhurmë.)

- Hanna:** Oh, mos!  
**1. Hotelgast:** Oh – prisni!  
**Ex:** Oho! U theyen të gjitha!  
**Hanna:** Faleminderit! Faleminderit shumë! Është mirësjellje nga ana juaj.  
**Ex:** Po, është mirësjellje.

Në skenën e dytë hyjnë në dhomën ku babet mëngjesi një burrë gjysëm i përgjumur.

- Hanna:** Mirëmëngjes.  
**2. Hotelgast:** M'ngjes!  
**Hanna:** Dëshironi çaj apo kafe?  
(Burri nuk përgjigjet)  
**Hanna:** Më falni, a doni çaj apo kafe?  
**2. Hotelgast:** A, më falni, jam akoma shumë i lodhur. Një kafe, ju lutem.

Në skenën e tretë, dr. Tyrmani takon rastësisht në hotel "Europa" një mik, të cilin nuk e ka parë prej kohësh.

- 1. Hotelgast:** Mirëmëngjes!  
**Dr. Thürmann:** Mirëmëngjes!  
**1. Hotelgast:** Po kush është ky? E çuditshme, shumë e çuditshme. Natyrisht është... Më falni, ju lutem!  
**Dr. Thürmann:** Urdhëroni.  
**1. Hotelgast:** Ju jeni zoti Tyrman, apo jo?  
**Dr. Thürmann:** Po. Dhe ti..., po ti je Stefani!

Në skenën e katërt, një i ri përpinqet të hapë një bisedë me një grua dhe prandaj i bën asaj shumë pyetje.

- Junger Mann:** Ju jeni gazetare dhe shkruani reportazhe?  
**Journalistin:** Po.  
**Junger Mann:** Interesante, shumë interesante. Kjo është shumë interesante.  
**Journalistin:** Po. Ashtu është.  
**Junger Mann:** Dhe me se merreni më konkretisht?  
**Journalistin:** Oh, bëj kërkime...  
**Ex:** Kërkime, kërkime...

Në skenën e pestë, dy të reja (njëra prej tyre është studente) konstatojnë se janë nga i njëjtë qytet, Augsburgu, një qytet pranë Mynihut.

|                       |                                      |
|-----------------------|--------------------------------------|
| <b>1. junge Frau:</b> | <i>Dhe me se merresh ti?</i>         |
| <b>2. junge Frau</b>  |                                      |
| <b>= Studentin:</b>   | <i>Unë jam studente.</i>             |
| <b>1. junge Frau:</b> | <i>Prej nga je?</i>                  |
| <b>Studentin:</b>     | <i>Nga Augsburgu.</i>                |
| <b>1. junge Frau:</b> | <i>Vërtet? Edhe unë andej jam.</i>   |
| <b>Studentin:</b>     | <i>Si? Edhe ti nga Augsburgu je?</i> |

*Më tej, Eksa e pyet Andrean se nga është ai dhe Andrea, duke bërë shaka, e pyet Eksën se nga është ajo.*

**Ex:** *Andrea, nga je ti?*  
**Andreas:** *Unë jam nga Këlni. Po ti? Nga je ti?*

*Në skenën e shtatë mësoni se si u njoh Eksa (e cila është e padukshme, por zëri i së cilës dëgjohet shumë mirë) me Andrean. Andrea po lexonte një libër gojëdhënash për "Shpirrat e mirë të Këlnit". Në libër tregohej se këta Shpirtra shkonin gjithmonë natën te ustallarët dhe ua mbaronin punët e ditës, gjë që i gëzonte pa masë banorët e Këlnit. Në atë çast, Andrea psherëtiu thellë dhe mendoi se nuk do të ishte keq sikur dikush ta ndihmonte edhe atë për të mbaruar punët. Por pastaj ai tha me vete se ajo nuk do të ndodhë kurrë, se ato "ditë të arta" "sowieso" (=vetëkuptohet) kishin mbaruar. Sapo dëgjoi fjalën magjike "sowieso" një vitore e vogël u sbkëput nga libri dhe u hodh te Andrea. Andrea e quajti atë Eks, që në latinisht do të thotë "me origjinë nga", "del nga", meqenëse ajo ishte shkëputur nga libri. Por Andrea nuk e kupton se "sowieso" është një fjalë magjike.*

**Andreas:** *Sikur të kisha edhe unë... Eb, tani gjithçka ka mbaruar.  
**Ex:** *Hbmm, hbmm. Tungatjeta! Tungatjeta! Ja ku jam unë.  
**Andreas:** *Kush je ti?  
**Ex:** *Unë jam... unë.****

## **Mësimi 9** **Po ti e di këtë!**

*Eksa është kureshtare dhe do të dijë sa të jetë e mundur më shumë rrëth dr. Tyrmanit. Ajo, së bashku me Andrean kërkojnë në regjistrin e hotelit emrin dhe mbiemrin e dr. Tyrmanit. Kjo i bën ata të flasin për emrat dhe mbiemrat e tyre.*

**Andreas:** *Ja ku është – mbiemri: Tyrman.  
**Ex:** *Po unë e di këtë! Vazhdo më tej.  
**Andreas:** *Emri: Lukas.  
**Ex:** *Emri?  
**Andreas:** *Po. Emri.  
**Ex:** *Po ti, si e ke emrin?  
**Andreas:** *Po ti e di këtë! Andreas. Kurse ti quhesh...  
**Ex:** *Unë nuk e di.  
**Andreas:** *E di unë, pa. Emri: Eks, mbiemri: Hex (= shtrigë)  
**Ex:** *Jo – jo!**********

*Pas kësaj paranteze Eksa dhe Andrea vazhdojnë të merren me dr. Tyrmanin: ai është mjek, ka lindur në Lajpcig dhe banon në Berlin.*

- Andreas:** Pra, le të vazhdojmë: profesioni...  
**Ex:** C'punë bën ai?  
**Andreas:** Është mjek, atë edhe e quajnë doktor Tyrman.  
**Ex:** C'profesion ke ti?  
**Andreas:** Jam student dhe sportelist. Unë vazhdoj studimet dbe punoj si sportelist.  
**Ex:** Vazhdo: vendlindja! Prej nga është ai?  
**Andreas:** Ai është nga Lajpcigu.  
**Ex:** Vazhdo: vendbanimi!  
**Andreas:** Një minutë: ja ku është – Berlin! Ai banon në Berlin.

### **Mësimi 10**

#### **A keni një dhomë të lirë?**

*Andrea është në sportel dbe po merret me punën e tij. Eksa nuk pushon së bëri pyetje Andreas.*

- Ex:** Andrea, po punon?  
**Andreas:** Po.  
**Ex:** Andrea, punon shumë ti?  
**Andreas:** Po.  
**Ex:** Andrea, je i lumtur?  
**Andreas:** Hm.  
**Ex:** Ç'do të thuash me "bm"? Po apo jo?  
**Andreas:** Gjithmonë kaq shumë pyetje bën ti?  
**Ex:** Gjithmonë.  
**Andreas:** Shët – dikush po vjen!

*Në hotel byn një klient i ri. Ai pyet nëse ka ndonjë dhomë të lirë dhe, nëse ka, sa kushton ajo. Klienti, zoti Majer, thotë se dëshiron të qëndrojë aty dy ose tri ditë.*

- Andreas:** Mirëmbërëma.  
**Gast:** Mirëmbërëma. A keni ndonjë dhomë të lirë?  
**Andreas:** Dhomë njëshe apo dhomë dyshe?  
**Gast:** Dhomë njëshe, ju lutem.  
**Andreas:** Me banjo?  
**Gast:** Po.  
**Andreas:** Sa kohë do të qëndroni?  
**Gast:** Dy ose tri ditë.  
**Andreas:** Në rregull. Dhoma dbjetë është akoma e lirë.  
**Gast:** Sa kushton dhoma?  
**Andreas:** Njëqind e njëzet marka. Me gjithë mëngjesin.  
**Gast:** Mirë.  
**Andreas:** Ja ku e keni çelësin – dhe kalofshi një natë të mirë, zoti Majer.  
**Gast:** Faleminderit.

*Me sa duket zoti Majer është muzikant, sepse nga dhoma e tij dëgjoben tingujt e një flauti.*

**Andreas:** Sa bukur!  
**Ex:** Qetësi! Qetësi, të lutem!

### **Mësimi 11** **Prapë një dhomë në këtë gjendje!**

Hana Klazen, pastruesja e dhomave në hotel "Europa", zemërohet pasi një klient e ka lënë dhomën shumë rrëmuje.

**Frau Berger:** Mirëmëngjes, Hana.  
**Hanna:** Mirëmëngjes, zonja Berger. Oh, jo – prapë një dhomë në këtë gjendje! Të marrë dreqi!  
**Frau Berger:** Si është puna, Hanna?  
**Hanna:** Ah, kjo dhomë është vërtet një stallë derrash.  
**Frau Berger:** Nuk ka asgjë të re këtu.  
**Hanna:** Keni të drejtë.

Hana fillon të zbrazë tavllën e cigareve dhe të nxjerrë shishet nga dhoma. Duke pastruar, ajo ankohet për ndarjen e padrejtë të roleve: burrat pijnë cigare, kurse gratë dubet të pastrojnë.

**Hanna:** Kjo është e zakonshme – një shishe, ja dhe një tjetër – ob, shishja qenka gjysmë e mbushur. Tavlla – plot! Natyrisht, burrat pijnë, gratë pastrojnë.  
**Ex:** Dbe këndojnë:  
**Hanna:** Çfarë? A ka njeri aty?

Eksa kureshtare vazhdon "zbulimet" e saj në hotel: ajo i pa dbe i dëgjoi të gjitha, ndaj e tall klientin, i cili është muzikant duke e quajtur me fjalën nënveftësuese "Musikant" (= sazexhi)

**Frau Berger:** Është gjithçka në rregull, Hana? Oh – këtu është një flaut.  
**Ex:** Një sazexhi – tërheqës dhe rrëmujaxhi.  
**Hanna:** A ka njeri aty?  
**Frau Berger:** A ka njeri aty? E çuditshme...

### **Mësimi 12** **Student apo sportelist?**

Andrea po kërkon Eksën. Ai e dëgjon zérin e saj në dhomën ku është Hana. Dhe në këtë mënyrë Andrea njihet edhe me Hanën. Njëkohësisht Andreas i dubet t'i shpjegojë zonjës Berger se ç'kërkon në atë dhomë.

**Frau Berger:** E çuditshme.  
**Ex:** Çfarë është e çuditshme?  
**Frau Berger:** A ka njeri aty?  
**Ex:** Po, jemi ne!  
**Andreas:** Shëët, Eks – pusho!  
**Frau Berger:** Ç'po bëni ju këtu?  
**Ex:** Ne po studiojmë.  
**Hanna:** Si thatë?

- Andreas:** Po. Jo, pra ne... (i mbabet goja) – unë u bëra vetëm kureshtar.
- Frau Berger:** Interesante. Më tregoni: ju jeni vetëm, apo jo? Thoni gjithmonë “ne” kur nënkuptoni “unë”?
- Andreas:** Jo, natyrisht jo!
- Andrea i prezantohet Hanës si student dbe sportelist. Hana prezantohet si pastruese dhomash. Dhe zonja Berger duket e zbavitur.*
- Hanna:** Ju jeni i ri këtu, apo jo? Jeni sportelisti, besoj.
- Andreas:** I ratë pikës!
- Hanna:** Po pse thoni “ne studiojmë”?
- Andreas:** Unë jam student.
- Hanna:** Atëberë, çfarë jeni tamam: student apo sportelist?
- Andreas:** Student dbe sportelist.
- Hanna:** E kuptoj. Mirë, unë jam Hana. Pastruesja.
- Frau Berger:** Mirë – tanë në punë!
- Hanna:** Në rregull. Mirupafshim!
- Ex:** Çiao!

### ***Mësimi 13***

#### ***Urdhëroni çelësin tim!***

*Skenat e mëposhtme zhvillohen në sportelin e hotelit “Europa”.*

- Skena 1:** Zoti Majer dorëzon çelësin e dhomës.
- Andreas:** Mirëmëngjes, zoti Majer. Si jeni?
- Herr Meier:** Mirë. Faleminderit.
- (Zoti Majer e lë çelësin e tij mbi banak.)
- Herr Meier:** Urdhëroni çelësin tim!
- Andreas:** Faleminderit. Ditën e mirë.
- Herr Meier:** Mirupafshim.

- Skena 2:** Andrea i kthen pasaportën një klienteje.
- Andreas:** Mirëmëngjes.
- Frau:** Mirëmëngjes.
- Andreas:** Urdhëroni pasaportën.
- Frau:** Oh po, faleminderit. Mirupafshim.

- Skena 3:** Andrea i jep dr. Tyrmanit një letër. Por dr. Tyrmani nuk mund ta lexojë letrën, sepse nuk di se ku i ka vënë syzet. Ai ka harruar se syzet i ka mbi ballë.
- Andreas:** Mirëmëngjes, zoti doktor. Si jeni?
- Dr. Thürmann:** Mirëmëngjes. Çka, faleminderit.
- Andreas:** Këtu ka ardhur një letër për ju.
- Dr. Thürmann:** Letër? Syzet – nuk di se ku i kam lënë syzet. Nga vjen letra?
- Andreas:** Nga Berlini. Më falni, zoti doktor, ja ku i keni syzet.
- Dr. Thürmann:** Epo, kështu... po plakem.

- Skena 4:** Eksa e zemëron Andream që përpinqet të mbarojë punët e tij.  
**Ex:** Hm, hm.  
**Andreas:** Ai është stilografi im.  
**Ex:** Stilografi yt? Oh, unë s'e dija. Mos janë edhe këto syzet e tua?  
**Andreas:** Jo. Eks, rri urtë. Unë jam duke punuar.  
**Ex:** Punë, punoj, njeriu gjithmonë punon...

### Mësimi 14 Ju do të vini në Aben, apo jo?

Andrea po u shkruan një letër prindërve. Ai u tregon atyre për punën e tij në hotel "Europa" dbe për njerëzit me të cilët ka të bëjë, për shembull për dr. Tyrmanin dbe zotin Majer.

"Të dashur prindër,  
 Ju e dini: studentët gjithmonë kanë nevojë për para. Unë po punoj përsëri si sportelist në hotelin "Europa", në Aben. Puna është e re dbe interesante. Gjithnjë vjen dikush që kërkon një dhomë, një birrë apo një taksi... ose dikush që pyet: ku i kam paratë, ku i kam lënë syzet, ku është pasaporta ime? Njerëzit me sa duket mendojnë se sportelisti di gjithçka. Unë bëj edhe studime: studioj karakteret njerëzore!"

Dr. Tyrmani, p.sh. është një mjek nga Berlini. Ai është i dashur, por bën shumë pyetje. Pastaj është edhe zoti Majer, një muzikant. Atij, me sa duket, i pëlqen cigara dbe pija.

Edhe unë vazhdoj të pij cigare, që janë shumë të shtrrenjta, përfat të keq.  
 Ju do të vini në Aben, apo jo?"

Në atë moment, Eksa e ndërtimet Andream dbe e pyet se kush do të vijë në Aben. Veç kësaj, ajo e pyet Andream se pse nuk e ka përmendur atë, Eksën, në letër.

- Ex:** Kush, pikërisht?  
**Andreas:** Prindërit e mi.  
**Ex:** Po për mua? Ku shkrubet: Eksa është shoqja ime?  
**Andreas:** Aha, ti e ke fjalën për...

Eksa mendon se Andrea duhet t'u flasë prindërve edhe për të. Por Andrea nuk është dakord.

- Ex:** Po!  
**Andreas:** Oh, Eks, kjo nuk është e mundur.  
**Ex:** E pse jo?

Pjetjes së fundit Andrea nuk i përgjigjet më, pasi do që të përfundojë letrën. Mirupafshim së shpejti.  
 "Juaji...Andrea."

### Mësimi 15 Do t'i shesësh edhe kasetat?

Andrea ndodhet në shtëpi dhe po ndan mënjanë sendet e vjetra, të cilat do t'i shesë në tregun e vjetësirave. Në këtë treg njerëzit shesin sendet që nuk u duhen më. Eksa po vështron Andream.

- Ex:** *Pse janë përbapur kudo gjërat e tua?*  
**Andreas:** *Do t'i shes.*  
**Ex:** *Çfarë? Do t'i shesësh? Ku?*  
**Andreas:** *Nesër bëhet një pazar sendesh të përdorura, pazar pleshti.*  
**Ex:** *Pazar pleshti? Pazar pleshti? Do të shesësh pleshta?*  
**Andreas:** *Jo. Do të shes: (shtrigën) Ex Hex.*  
**Ex:** *Jo, të lutem, mos!*

*Pastaj Eksa e pyet Andreean nëse ai ka ndër mend t'i shesë edhe disqet dhe kasetat. Andrea është ende i pavendosur për këtë.*

- Ex:** *Do t'i shesësh edhe kasetat?*  
**Andreas:** *Po – janë të vjetra dbe unë nuk i dëgjoj më.*  
**Ex:** *Po disqet? Edhe ato do t'i shesësh?*  
**Andreas:** *Nuk e di. Nuk besoj t'i shes.*  
**Ex:** *Janë të reja?*  
**Andreas:** *Jo, natyrisht që jo.*  
**Ex:** *Na vërt të dëgjojmë një disk!*  
**Andreas:** *Mirë.*

### *Mësimi 16*

#### *Provogeni njëherë!*

*Andrea i ka hapur sendet dbe plaçkat e tij në tregun e vjetërsirave. Rastësishtr në këtë treg po shëtit zonja Berger. Andrea përpiqet ta bindë atë që të blejë një shall.*

- Andreas:** *Mirëdita, zonja Berger. Si jeni?*  
**Frau Berger:** *Mirëdita. Mirë, faleminderit.*  
**Andreas:** *Ndoshta dëshironi një shall? Shikojeni njëherë këtë këtu: është shumë fin.*  
**Frau Berger:** *Jo, faleminderit.*  
**Andreas:** *Provogeni njëherë – ja dbe pasqyra.*  
**Frau Berger:** *Jo, me të vërtetë. Faleminderit shumë.*  
**Andreas:** *Sa keq!*

*Por pikërisht në atë çast zonja Berger zbulon midis sendeve që po shet Andrea një libër, të cilin ajo e ka kérkuar prej kohësh. Dhe këtë libër ajo dëshiron ta blejë.*

- Frau Berger:** *Oh, ai është i mrekullueshëm. Është pikërisht libri që kam kérkuar.*  
**Andreas:** *Pa dale... aba shpirrat "Heinzelmännchen".*  
**Frau Berger:** *Sa kushton?*  
**Andreas:** *Një markë.*  
**Frau Berger:** *Mirë, do ta marr.*

*Por Eksa nuk do që Andrea ta shesë librin, sepse është pikërisht libri nëpërmjet të cilit Eksa dbe Andrea u njobën me njëri-tjetrin.*

- Ex:** *Jo! Këtë libër nuk do ta shesësh!*  
**Frau Berger:** *Si?*  
**Andreas:** *Më falni, zonja Berger. Nuk do ta shes librin. Më vjen keq.*  
**Frau Berger:** *Atëherë, përsë e keni vendosur këtu? Epo, mirupafshim!*  
**Andreas:** *Ex, si është puna?*  
**Ex:** *Po ky është..., po ky është libri ynë! Unë e dua atë!*

## **Mësimi 17**

### **Katër filxhanë – bëjnë katër marka**

Katër skenat e mëposhtme zhvillohen në tregun e sendeve të vjetra, ku njerëzit po enden duke shpresuar të gjejnë diçka të lirë ose jo të zakonshme. Në skenën e parë një grua bën pazar me shitësin dbe arrin ta ulë çmimin e një bluze.

**Junge Frau:** Mua kjo bluzë më duket shumë e bukur.

**Freundin:** Ma trego dhe mua! Hm. – Provoje njëherë! Po. Mirë.

**Junge Frau:** Sa kushton kjo bluzë?

**Verkäufer:** Dymbëdhjetë marka.

**Junge Frau:** Dymbëdhjetë marka? Shumë shtrenjtë. Tetë marka.

**Verkäufer:** Njëmbëdhjetë marka.

**Junge Frau:** È marr – pér dbjetë marka.

**Verkäufer:** Dakord. Dhjetë marka.

Në skenën e dytë një shitës po shet filxhanë.

**Junger Mann:** Si tē duken filxhanët?

**Freundin:** Çka.

**Junger Mann:** Sa kushton një filxhan?

**Verkäufer:** Një filxhan – një markë e pesëdhjetë. Dy filxhanë – dy marka.

**Junger Mann:** Më jepni katër filxhanë.

**Verkäufer:** Katër filxhanë – bëjnë katër marka.

Në skenën e tretë, një fëmijë ka humbur nënën dbe një grua e ndihmon pér ta gjetur atë.

**Kind:** Mami! O mami! O mami, ku je?

**Frau:** Ku e ke mamin?

**Kind:** Nuk e di.

**Frau:** Hajde ta kërkojmë bashkë!

Në skenën e katërt, Eksa zbulon një “xbuxh kopshti”, një kukull me pamjen e një xbuxhi, të cilin në fillim ajo e merr pér kukudh.

**Ex:** Andrea, shiko: një kukudh!

**Andreas:** Jo, Eks. Ai është një “xbuxh kopshti”.

**Ex:** Cfarë është?

**Andreas:** Ti e di që gjermanëve u pëlqejnë shumë “xbuxhat e kopshtit”.

**Ex:** Edhe mua më pëlqejnë. Të lutem, dua edhe unë...

## **Mësimi 18**

### **As plaçka, as bagazh**

Është mëngjes herët. Pas pushimit të fundjavës, Andrea sapo ka ngrënë mëngjes dbe bëhet gati pér t'u nisur në hotel. Ai nxiton. Eksa nuk ka dëshirë ta shoqërojë.

**Andreas:** Eks, unë po nisem. Ti do tē vish?

**Ex:** Nuk kam qejf të vij.

**Andreas:** Në rregull. Ti nuk ke qejf, unë nuk kam kohë. Atëherë rri në shtëpi. Mirupafshim!

**Ex:** Andrea, më prit, të lutem. Unë po vij.

Në hotel, Hana, pastruesja e dhomave pret që të vijë Andrea. Ajo është shumë e nervozuar, pasi me sa duket zoti Majer ka ikur pa paguar.

**Hanna:** Andrea, eja shpejt!

**Andreas:** Si është puna?

**Hanna:** Zoti Majer ka ikur.

**Andreas:** Çfarë?

**Hanna:** Ai nuk ka paguar! Eja shpejt!

Hana i tregon Andreas dhomën bosh. Aty ka mbetur vetëm flauti i zotit Majer. Të dy vendosin atëherë të shkojnë të drejtoresha e hotelit.

**Hanna:** Shiko – dhoma është bosh. S'ka as plaçka, as bagazh.

**Andreas:** Edhe banjoja është bosh: nuk është as makina e rrojes, as furça e dhëmbëve.

**Hanna:** Ai ka ikur!

**Andreas:** Nuk e besoj të ketë ikur! Hej, shiko: flauti është akoma këtu!

**Hanna:** Po tanë? Ke ndonjë ide?

**Ex:** Koha është këshilltari më i mirë.

**Andreas:** E di shefja këtë?

**Hanna:** Jo.

**Andreas:** Eja ta pyesim.

## Mësimi 19

### Dua të fle

Hana dhe Andrea i tregojnë drejtoreshës së hotelit, zonjës Berger, se zoti Majer me sa duket ka ikur pa paguar për hotelin. Pastaj të tre fillojnë të bëjnë supozime: Zonja Berger mendon se zoti Majer thjesht është pak kaotik dhe se nuk ka vend për t'u shqetësuar. Hana mendon se zoti Majer u ka lënë shëndenë dhe nuk do të kthehet më. Kurse Andrea është i sigurtë se zoti Majer do të vijë për të kërkuar flautin e tij.

**Frau Berger:** Ju lutem, ta marrim me qetësi. Ju e dini se zoti Majer është muzikant. Ai është pak kaotik.

**Hanna:** Ai ka ikur! Për gjithmonë.

**Andreas:** Po flautin e ka akoma këtu!

**Frau Berger:** Aha, po mirë...

**Andreas:** Me siguri që do të vijë ta kërkojë.

**Frau Berger:** Pa dyshim. Një flaut si ai është shumë i kushtueshëm. Ai me siguri do të kthehet.

**Ex:** Sido që të jetë!

**Frau Berger:** Ashtu? Mirë, le të presim pak.

**Andreas:** Në rregull.

Dhe me të vërtetë, zoti Majer kthehet ne hotel vonë në mbrëmje dbe i rraskapitur.

**Ex:** Shiko: Po vjen zoti Majer.

**Andreas:** Shyqyr Zotit!

**Ex:** Mbase ai do të paguajë tanë?

**Andreas:** Shëët – Eks – shët. Mirëmbrëma, zoti Majer. Si jeni?

**Herr Meier:** Keq. Jam shumë i lodbur. Dua të fle, të fle... Dua të qëndroj edhe një natë. A është e mundur?

**Andreas:** Një minutë, ju lutem. Po.

- Herr Meier:** Shyqyr Zottit! Ab, kam edhe diçka tjetër: flauti im... E keni gjë flautin tim?
- Andreas:** Po – flautin tuaj e ka zonja Berger.
- Herr Meier:** Shyqyr Zottit!
- Andreas:** Atëherë ... gjumë të ëmbël.
- Herr Meier:** Oh – ju faleminderit, ju faleminderit!
- Ex:** E kur do të paguajë ai?
- Andreas:** Eks – shëët!

## Mësimi 20 Jeni i sëmure?

Zonja Berger dëshiron të flasë me zotin Majer. Por me sa duket zoti Majer është në shtrat, i sëmure.

(Zonja Berger troket në derën e tij)

**Frau Berger:** Zoti Majer? Zoti Majer, jeni aty? Zoti Majer?

**Herr Meier:** Po.

(Zonja Berger byn në dhomën e tij)

**Frau Berger:** Ç'keni, zoti Majer? Jeni sëmure?

**Herr Meier:** Po.

**Frau Berger:** Keni dhimbje?

**Herr Meier:** Po, po.

**Frau Berger:** Ku ndieni dhimbje?

**Herr Meier:** Kudo. Çdo gjë më dhemb.

**Frau Berger:** Më duket se keni temperaturë. Prisni pak! Do të kthehem menjëherë.

Dr. Tyrmani është mjek. Ai e viziton zotin Majer dbe konstaton se ai ka grip.

**Dr. Thürmann:** Hë, zoti Majer, si e ndieni veten?

**Herr Meier:** Keq. Me të vërtetë keq.

**Dr. Thürmann:** Ku keni dhimbje?

**Herr Meier:** Koka, sytë, fytì – gjithçka, gjithçka më dhemb.

(Dr. Tyrmani e viziton zotin Majer)

**Dr. Thürmann:** Ju dhemb këtu?

**Herr Meier:** Po.

**Dr. Thürmann:** Po këtu?

**Herr Meier:** Jo. Por këmbët, këmbët i kam shumë të rënda.

**Dr. Thürmann:** Mirë, keni grip. Nuk është kaq serioze.

**Herr Meier:** Shyqyr Zottit!

**Dr. Thürmann:** Të shkuara, zoti Majer!

**Herr Meier:** Ju faleminderit. Ju faleminderit shumë.

## Mësimi 21 Unë isha në Esen

Zonja Berger i drejtobet në dhomën e ngrënies zotit Majer, i cili është shëruar nga gripi.

**Frau Berger:** Mirëmëngjes, zoti Majer. A ndiheni më mirë?

**Herr Meier:** Po, ju faleminderit. Shyqyr Zottit.

**Frau Berger:** Shumë mirë. Ab, doja i ju thosha: flautin tuaje kam akoma unë.

- Herr Meier:** Po, e di.  
**Frau Berger:** Mund tē shkojmë nē zyrën time. Atje éshtë flauti.  
**Herr Meier:** Po. Me gjithë qejf.
- Pastaj zonja Berger e sjell bisedën te mungesa e zotit Majer. Ai kërkon falje dbe thotë se do të paguajë menjëherë.*
- Frau Berger:** E kuptioni? Ishte e çuditshme: dboma juaj ishte bosh, tē gjitha plaçkat ishin marrë, ju kishit ikur...  
**Herr Maier:** Dhe nuk kisha paguar. E kuptoj shqetësimin tuaj.  
**Frau Berger:** Mirë, atëhere çdo gjë éshtë nē rregull.  
**Herr Meier:** Ju lutem tē më falni. Do të paguaj menjëherë.

- Zoti Majer do që ta shpjegojë më me hollësi atë që ka ndodhur. Ai ishte nē Esen, te shoqja e tij, por u grind me tē.*
- Herr Meier:** Pra, unë isha këtu nē Ahen.  
**Frau Berger:** Po, e di.  
**Herr Meier:** Kisha një koncert nē Ahen.  
**Frau Berger:** Aha – interesante.  
**Herr Meier:** Dhe pastaj isha nē Esen.  
**Frau Berger:** Ishtë nē Esen?  
**Herr Meier:** Po. Mikesha ime jeton atje. Por patëm një diskutim.  
**Frau Berger:** Atëherë me siguri keni patur probleme.  
**Herr Meier:** Dhe çfarë problemesh! Pas kësaj ika dbe u ktheva nē Ahen.

- Dhe Eksa këndon, pasi mendon që u vërtetua karakterizimi i saj për muzikantin.*
- Ex:** Na ishte njëherë një sazexhi, simpatik dbe rrëmujaxhi.

## Mësimi 22

### Po gruaja e tij?

- Dy gra janë ulur nē hollin e hotelit dbe diskutojnë për njerëzit që kalojnë para tyre. Në fillim ato flasin për dr. Tyrmanin.*
- Frau Müller:** Ja ku éshtë ai!  
**Frau Hoffmann:** Zoti Tyrman?  
**Frau Müller:** Po.  
**Frau Hoffmann:** Éshtë me tē vërtetë simpatik. Po ç'punë bën?  
**Frau Müller:** E pra, dëgjoni këtu! Ai éshtë profesor!  
**Frau Hoffmann:** Aba – profesor! E nga éshtë ai?  
**Frau Müller:** Nga Berlini.  
**Frau Hoffmann:** Pse nuk thoni! Ju i ditkeni tē gjitha.  
**Frau Müller:** Epo, tanë...  
**Frau Hoffmann:** Po gruaja e tij? Dua tē them: a éshtë i martuar?  
**Frau Müller:** Këtë nuk e di. Por nuk besoj tē jetë i martuar.

- Dr. Tyrmani kalon para dy zonjave dbe i përshtëndet.*
- Dr. Thürmann:** Mirëdita.  
**Frau Müller:** Mirëdita, zoti Tyrman.  
**Frau Hoffmann:** Mirëdita, zoti profesor.

*Pastaj ato flasin pér një vajzë që po afrobet drejt tyre, një franceze.*

**Frau Müller:** Ja ku éshëtë ajo!

**Frau Hoffmann:** Kush?

**Frau Müller:** Ajo vajza, pra, që rri në dhomën dymbëdhjetë.

**Französın:** Mirémengjes. Ju uroj një mëngjes të këndshëm.

**Frau Müller:** Mirémengjes... Ajo éshëtë franceze.

**Frau Hoffmann:** Kuptohet menjëherë nga akcenti.

**Frau Müller:** Nënën e ka franceze.

**Frau Hoffmann:** Ashtu? Po të atin?

**Frau Müller:** Ai éshëtë gjerman. Diplomat.

**Frau Hoffmann:** Ah, interesante! Po ajo – me se merret? E kam fjalën, ç'punë bën?

**Frau Müller:** Phë, nuk e di. Ndoshta éshëtë studente.

**Frau Hoffmann:** Hm.

**Frau Müller:** Ob, shikoni: djaloshi i dhomës katërmëbëdhjetë!...

*Kurse Eksa e shpreh mendimin e saj pér të dyja zonjat në një thënie me rimë, ku i quan ato “duet”.*

**Ex:** Dueti shfrytëzon rastin si i do qejfi!

### **Mësimi 23**

#### **Kush flet atje?**

*Andrea po lexon një libër. Eksa nuk e lë të qetë duke e pyetur se çfarë po bën.*

*Andrea i përgjigjet se ajo e sheh mirë që ai po lexon. Kjo e mërzit Eksën, e cila i thotë se ajo éshëtë e padukshme dhe se nuk sheh gjë fare.*

**Ex:** Andrea, çfarë po bën?

**Andreas:** Po lexoj.

**Ex:** Çfarë po lexon?

**Andreas:** Po lexoj një libër. Ti e sheh mirë!

**Ex:** Unë nuk shikoj gjë, nuk shikoj gjë fare. Unë jam e padukshme dhe nuk shikoj asgjë.

**Andreas:** Eksa nuk shikon asgjë dhe bezdis shumë.

*Eksa thërret me zë të lartë se e ka marrë uria. Këtë e dëgjon zonja Berger, e cila prej kohësh ka dashur të zbulojë se i kujt éshëtë ky zë i çuditshëm. Pér këtë arsyë ajo e pranon ftesën e Andreas që të shkijnë pér të ngrënë diku së bashku. Andrea sapo e ka mbaruar së lexuari librin.*

**Andreas:** Mbaroi dbe kjo punë!

**Ex:** O, olele, më dhemb barku!

**Andreas:** Ç'ke Eks?

**Ex:** Më ka marrë uria.

**Andreas:** Eksën e ka marrë uria?

**Ex:** Vetëkuptohet! Uria!

**Frau Berger:** Edhe unë jam e uritur.

**Andreas:** Mirëmbërëma, zonja Berger.

**Ex:** Shkjmë të hamë bashkë?

**Frau Berger:** Nuk éshëtë ide e keqe! Por më thoni njëherë: kush flet atje? Unë shoh vetëm ju.

**Andreas:** Unë jam ventriloq.

**Frau Berger:** *Aba! Interesante.*  
**Andreas:** *Po, por këtë e mbaj të fshehtë.*  
**Ex:** *Ikim!*

### **Mësimi 24** **Dësbironi edhe një kafe?**

Në Gjermani, njerëzit shpesh shkojnë për të ngrënë në piceri. Në këto restorante italiane mund të habet mirë dhe çmimet janë të arsyeshme. Edhe zonja Berger, Eksa dhe Andrea ndodhen tanë në një piceri. Zonja Berger dëshiron të hajë sallatë dhe peshk, ndërsa Andrea porosit një pice.

**Andreas:** *Gjfarë do të merrni?*  
**Frau Berger:** *Sì fillim një sallatë, pastaj... pastaj... pastaj - peshk. Po ju? C'do të merrni?*  
**Andreas:** *Një pice, me proshutë, me djathë dhe me domate.*  
**Ex:** *Kaq shumë?*  
**Frau Berger:** *Ja - përsëri zëri juaj i dyti!*  
**Andreas:** *Po. Është mjaf i paturpshëm.*

*Pastaj zonja Berger dhe Andrea vendosin se çdo të pijnë.*

**Andreas:** *Mirë, po për të pirë çdo të merrni?*  
**Frau Berger:** *Një ujë mineral. Po ju?*  
**Andreas:** *Një birrë.*  
**Frau Berger:** *Po zëri juaj i dyti?*  
**Ex:** *Një lëng portokalli.*  
**Andreas:** *Rri urtë tanë!*  
**Frau Berger:** *Mjaf i paedukuar, zëri juaj i dyti.*  
**Andreas:** *Atëherë, unë po porosis.*

*Andrea thërret kamerierin dhe i lutet të bëjë llogarinë. Në Gjermani, zakonisht secili paguan më vete, pra pagubet "veç". Kështu që edhe zonja Berger dëshiron t'i paguajë vetë ato që ka ngrënë.*

**Andreas:** *Dësbironi edhe një kafe?*  
**Frau Berger:** *Jo, saleminderit.*  
**Andreas:** *Në rregull - kamerier! Faturën, ju lutem!*  
**Ober:** *Po, erdha menjëherë. Do t'i paguani të gjitha bashkë, apo vec e vec?*  
**Andreas:** *Të gjitha bashkë.*  
**Frau Berger:** *Jo. Vec, e vec.*  
(Duke ju drejtuar Andreas)  
*Ju nuk keni dbe kaq shumë para, apo jo?*

### **Mësimi 25** **Unë do të paguaj pjesën tjetër**

*Andrea, zonja Berger dhe Eksa mbaruan së ngrëni. Zonja Berger paguan për vete e i jep kamerierit edhe një bakshish.*

**Ober:** *Ju do të paguani...*  
**Frau Berger:** *Do të paguaj për sallatën, peshkun dbe ujin mineral.*  
**Ober:** *Këto bëjnë njëzet e dy marka e pesëdhjetë.*

**Frau Berger:** Njëzet e pesë.  
**Ober:** Shumë faleminderit.

*Andrea bëhet gati të paguajë pjesën tjetër, kur konstaton se ka harruar portofolin.*

(Kamerieri kthehet nga Andrea)

**Ober:** Po ju, zotni?  
**Andreas:** Unë do të paguaj pjesën tjetër.  
**Ober:** Pra, një picë me proshutë.  
**Andreas:** Po, Edhe birrën.  
**Ober:** Këto bëjnë dbjetë marka e pesëdhjetë.  
**Andreas:** Portofoli! S'po e gjej portofolin. Duhet ta kem në pallto. Një minutë, ju lutem.

*Andrea vazhdon ta kërkojë portofolin, por më kot. Ai i ka harruar paratë në hotel. Dhe Eksa e dinte mirë këtë.*

**Andreas:** Mos e ke ti portofolin tim?  
**Ex:** Jo, nuk e kam.  
**Andreas:** Ta marrë dreqi! Nuk po e gjej. Vërtet që s'e ke ti?  
**Ex:** Vërtet që s'e kam.  
**Andreas:** Po – ku është atëherë?  
**Ex:** Në hotel!  
**Andreas:** Dhe ma thua këtë vetëm tani? Ti me të vërtetë nuk ke turp.  
**Ex:** Vetëkuqtohet!

*Si përfundim, zonja Berger i paguan të gjitha.*

**Frau Berger:** Epo mirë, atëherë, le t'i paguajmë të gjitha bashkë.

## Mësimi 26

### Ju ftoj

*Para se të largohet nga hoteli, dr. Tyrmani e pyet Andrean nëse ai ka dëshirë të shkojë në Berlin. Dr. Tyrmani do t'i ngarkojë atij një detyrë.*

**Andreas:** Mirëmëngjes, zoti doktor.  
**Dr. Thürmann:** Mirëmëngjes. Nesër do të largobem. E dinit, me siguri.  
**Andreas:** Po, natyrisht.  
**Dr. Thürmann:** Kam edhe një pyetje për ju. Do të kishit dëshirë që të vinit njëherë në Berlin?  
**Andreas:** Si, ju lutem?  
**Dr. Thürmann:** Po. Kam një punë për ju. Natyrisht, shpenzimet i marr përsipër unë, pra ju ftoj unë.

*Për Andrean kjo është diçka e papritur, prandaj ai kërkon të dijë më tepër.*

**Andreas:** Ftesa juaj më vjen shumë papritur.  
**Dr. Thürmann:** Ju e dini: Berlini është qytet interesant.  
**Andreas:** Natyrisht... Dhe ju keni një punë për mua?  
**Dr. Thürmann:** Po, unë do të doja...  
**Andreas:** Hm.  
**Dr. Thürmann:** Mendohuni edhe njëherë. Ja ku e keni numrin e telefonit tim. Më telefononi në Berlin!  
**Andreas:** Mirë. Do t'ju telefonoj.

*Dhe natyrish, edhe Eksa do që të shkojë me Andrean në Berlin.*

- Ex:**                   *Do të vij edhe unë.*  
**Andreas:**           *Do të vish edhe ti?*  
**Ex:**                   *Po, të lutem, të lutem!*  
**Andreas:**           *Ta shohim.*  
**Ex:**                   *Andrea, të kujtohet?*

*(Eksa imiton dr. Tyrmanin.)*

- Ex:**                   *"Interesante, shumë interesante."*  
**Andreas:**           *E vërtetë! Shumë e vërtetë!*